

E DREJTA PËR INFORMIM



Agjencia për Informim dhe Privatësi e Kosovës anëtarësohet në ICIC.



Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) e Republikës së Kosovës bëhet anëtare me të drejta të plota e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit.

Komiteti Ekzekutiv, si struktura vendimmarrëse e organizatës, ku anëtare është edhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u mbledh në takim në radhës dhe ka marrë vendimin unanim për pranimin e kandidaturës së AIP pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës.

Ky është një hap i rëndësishëm për autoritetin homolog të Kosovës në rrugën e tij për t'u bërë pjesë e organizatave ndërkombëtare të fushave të përgjegjësive, me qëllim përfitimin e eksperiencës në zbatimin e standardeve më bashkëkohore për ushtrimin praktik të të drejtave të qytetarëve.

Zyra e Komisionerit e ka mbështetur dhe do të vijojë t'i mbështesë këto përpjekje të AIP, jo vetëm për shkak të marrëdhënies së veçantë institucionale, por edhe si një nga angazhimet e parashikuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar në Tiranë në prill të 2022.

Konferenca numëron aktualisht 80 autoritete anëtare dhe 2 me status vëzhguesi.

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2022,



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2022, është shprehur me vendim për 22 ankesa. Me anë të vendimit nr. 59 datë 07.12.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", me objekt "Refuzim për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni si: Kopje e dokumentit për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Çmimit për Barnat për vitet 2014 - 2022; Kopje të listës së barnave me çmimet CIF, të miratuara për vitet: 2014 - 2022; Numri i fabrikave të prodhimit të barnave që janë licencuar në vend; numri i kërkesave nga subjekte vendas dhe të huaja që ka marrë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hapjen e fabrikave të prodhimit të barnave nga viti 2015 - 2022; Kopje e licencës së dhënë kompanive apo subjekteve fizike për ndërtimin e fabrikave të prodhimit të barnave në vend.

Autoriteti Publik, i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke i vendosur në dispozicion informacionin për pikën 3 dhe 4 të kërkesës. Për pikën 1 dhe 2 është shprehur se grumbullimi dhe përgatitja e tyre kërkojnë një punë voluminoze nga drejtoria përgjegjëse e ministrisë, ndërsa për sa i përket pikës së fundit, Qendra Kombëtare e Biznesit është institucioni përgjegjës për lëshimin e licencave për këtë kategori, si pasojë, kopja e licencave mund të aksesohet në faqen online të këtij institucioni.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e

mundur", Zyra e Komisionerit ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, Zyra e Komisionerit ftoi palët në seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë.

Ndërkohë, përfaqësuesja e Autoritetit Publik theksoi se qëllimi i Autoritetit Publik nuk është refuzimi i informacionit, por fakti se ky informacion është shumë voluminoz.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit, si edhe është konstatuar një interpretim i gabuar nga ana e tij.

Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar (Listat e barnave me çmimet CIF për vitet 2014 - 2022), duhet të ishte publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit Publik, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti në zbatim të nenit 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 1.10.2014 "Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të çmimit të barnave", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen në faqen zyrtare të ministrisë, të listës së përgjithshme me çmimet "CIF/EXW", të miratuar nga komisioni".


Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se informacioni i kërkuar gjendet lehtësisht në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kërkuesi i është cituar vetëm faqja zyrtare e institucionit ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresa e saktë e faqes ku ndodhet informacioni, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: "Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë

kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni." Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP-së www.idp.al.

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

- Vendim Nr. 56 - Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- Vendim Nr. 57 - Për refuzimin e rishikimit të akteve administrative
- Vendim Nr. 59 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Vendim Nr. 60 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Vendim Nr. 61 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Vendim Nr. 62 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Vendim Nr. 63 - Ministria e Drejtësisë
- Vendim Nr. 64 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Vendim Nr. 65 - Ministria e Kulturës
- Vendim Nr. 66 - Kryeministria
- Vendim Nr. 67 - Ministria e Brendshme
- Vendim Nr. 68 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Vendim Nr. 69 - Bashkia Divjakë



Së bashku për garantimin e të drejtave të qytetarëve

Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve është detyrim dhe përgjegjësi si në sferën publike të veprimtarisë shoqërore e ekonomike, ashtu edhe në atë private.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, Drejtori i Institutit të Nxënësve që nuk dëgjojnë, znj. Orjola Idrizi dhe Drejtori i Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, z. Emiliano Lule, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit institucional. Ky dokument ka për qëllim të nxisë aksesin në informacionin publik dhe mbrojtjen e të dhënave personale për këto komunitete, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin për ushtrimin në praktikë të këtyre të drejtave.



Marrëveshja ka si objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit për çështje që prekin objektin e veprimtarisë së tre palëve, duke u angazhuar, ndër të tjera në trajtimin e rasteve të individëve që u përkasin këtyre komuniteteve në raport me veprimtarinë e organeve të administratës publike apo entiteteve private, në optikën e fushës së përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit; rritjen e njohjes dhe ndërgjegjësimin me qëllim ushtrimin efektiv të të drejtave themelore të njeriut; propozimin e iniciativave për ndryshime rregullatore në rritjen e cilësisë së shërbimeve për këto komunitete.




Po ashtu, dokumenti parashikon organizimin e trajnimeve për forcimin e kapaciteteve administrative; zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin mbi ushtrimin e këtyre të drejtave; shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të reja në këto dy fusha; si dhe angazhimin në hartimin dhe prodhimin e materialeve ndërgjegjësuese si video/audio, fletëpalosje, broshura, etj, për këto komunitete.

Kërkoni informacion publik nëpërmjet E-albania ose regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve në portalin pyetshtetin.al




Ligji "Për të drejtën e informimit" parashikon se "Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet. Qytetarët mund ti drejtohen autoriteteve publike me kërkesë për informacion duke u loguar në portalin e-Albania dhe duke plotësuar formularin në shërbimin "Kërkesë për informacion publik", si edhe Zyrës së Komisionerit në rast se iu refuzohet dhënia e informacionit.

Për më shumë informacion mbi hapat që ndiqen për të aksesuar këtë shërbim ndiqni videon në këtë lidhje: 



Portali "Pyetshtetin.al" është një platformë online e cila synon t'i vijë në ndihmë qytetarëve për të gjetur me lehtësi informacion me karakter publik. Në këtë portal, gjenden të përditësuar të dhënat e të gjithë autoriteteve publike si: emërtesat e tyre, të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit, lidhjen me faqen zyrtare dhe veçanërisht me linkun e programit të transparencës së secilit autoritet publik.


Qytetari mund të ushtrojë të drejtën e tij për qasje në informacion nëpërmjet regjistrit elektronik i cili është i aksesueshëm në portalin pyetshtetin.al

Për më shumë informacion mbi hapat që ndiqen për të aksesuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve ndiqni videon në këtë lidhje 

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



idp.albania



IDP Albania



Komisioneri KDIMDP